



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1860 prot.

Tiranë më, 23.12. 2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 17, datë 23.12. 2020

PËR

**HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE EFEKTIVE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR
DHUNËS NDAJ GRAVE, DHUNËS NË FAMILJE, DHE DHUNËS ME BAZË
URREJTJE**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “dh” dhe 46 pika 3 shkronja “c” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit Penal, dhe të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” e ratifikuar me ligjin nr.104/2012,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridikSION të përgjithshëm që hetimet dhe ndjekja penale në çështjet për vepra penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje të jenë: në afate optimale (shpejta), eficente, dhe me kërkesa për masa dënimis efektive, proporcionale e frenuese, që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimateve gra.

2. Ky udhëzim ka për qëllim, gjithashtu, plotësimin e kuadrit nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktiminë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në vijim të udhëzimit

përgjithshëm nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, në fuqi, në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 2
Parimet

Veprimtaria e policisë gjyqësore dhe vendimarrja e prokurorit, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje, duhet të udhëhiqet nga parimet e:

- a) barazisë dhe mosdiskriminimit;
- b) aksesit në drejtësi;
- c) respektimit të dinjitetit;
- ç) procedimit pa vonesa;
- d) mbrojtjes nga riviktimizimi dhe sigurisë së viktimës;
- dh) dënimit që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shkelura nga vepra penale si dhe parandalimin;

Neni 3
Detyrimi për të njohur dhe zbatuar të drejtën ndërkombëtare

Prokurorët duhet të njojin¹ dhe të zbatojnë² standartet dhe normat e akteve/marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë.

KREU II
DHUNA ME BAZË GJINORE DHE DHUNA NË FAMILJE

Neni 4
Format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

1. Dhuna kundër grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave nëpërmjet akteve të dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje të paligjshme të lirisë, si në jetën publike ose atë private.

¹ Shih, por pa u kufizuar në atë listë, nenin 4 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”;

² Shih, nenin 122 të Kushtetutës së RSH, i cili në pikën 2 parashikon: “2.Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”

2. Dhuna gjinore kundër grave, përfshi dhe vajzat nën moshën 18 vjeç, nënkuption dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale.

3. Format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të parashikuara në Kodin Penal, dhe sipas kuptimit/interpretimit të Konventës së KiE-së “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”³ janë:

i) *Dhuna fizike* i referohet dëmtimit trupor që viktima vuan si pasojë e një ushtrimi të forcës trupore të menjëhershme dhe të paligjshme, përfshi dhunën që shkakton vdekje të viktimës;

ii) *Dhuna Psikologjike* i referohet çdo sjelljeje të qëllimshme që dëmton rëndë integritetin psikologjik të viktimës nga një person tjetër përmes shtrëngimit ose kërcënimit;

iii) *Përndjekja* është çdo formë e kontrollit apo mbikëqyrjes së drejtëpërdrejtë apo indirekte të viktimës, me ose pa kontakt fizik. Zakonisht, ajo ndodh pas përfundimit të marrëdhënies, por ajo mund të shfaqet edhe gjatë periudhës së marrëdhënies. Ajo mund, mes të tjerash, të përfshijë kërcënimet dhe ngacmimet, në internet apo jashtë internetit, duke e ndjekur personin, spiunuar, apo duke i shkaktuar viktimës frikë për sigurinë e saj ose të afërmve a personave të lidhur me të;

iv) *Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin*, mbulon të gjitha format e akteve seksuale të kryera mbi viktimën nga një person tjetër pa pëlqimin e dhënë lirisht prej saj dhe të kryera qëllimi shtesë ndaj saj. Gjithashtu, dhuna seksuale përfshin/mbulon akte të padëshirueshme të natyrës seksuale dhe midis bashkëshortëve;

v) *Martesa e detyruar* i referohet dhunës/forcës fizike ose psikologjike e ushtruar mbi viktimën për lidhje të pavullnetshme në martesë, ku përfshihet edhe joshja e një personi/viktimës për të shkuar jashtë shtetit me qëllim detyrimin e tij/saj për të lidhur martesë;

vi) *Ndërpreja e shtatzënësisë* i referohet ndërprerjes së një shtatzënësie, pa pëlqimin paraprak të gruas/viktimës e cila është informuar dhe ka kuptuar procedurën që do të ndiqet dhe pasojat e saj;

vii) Ngacmimi seksual i referohet sjelljes verbale, jo-verbale ose fizike me natyrë seksuale dhe pa dëshirën e viktimës, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të saj;

viii) Sterilizimi dhe gjymtimi i organeve gjenitale⁴ (përsa nuk parashikohen si vepër penale më vete) konsiderohen vepra penale ndaj shëndetit, të kryera me dashje me pasoja dëmtim të përhershëm ndaj shëndetit të viktimës⁵, në rrethanën rëndruese “j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë...”⁶.

Neni 5

Marrja e të dhënave nga viktima⁷

³ Shih, Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” e ratifikuar me ligjin nr.104/2012.

⁴ Shih, po aty, shkronja “a” e nenit 38 “Gjymtimi i organeve gjenitale femërore” dhe shkronja “b”; e nenit 39 “...sterilizimi i detyruar”;

⁵ Shih, nenin 88 të Kodit Penal;

⁶ Shih, nenin 50 shkronja “j” e Kodit Penal;

⁷ Shih, nenin 28 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimate dhe dëshmitarëve të veprave penale”.

Gjatë marrjes së të dhënave/intervistimit nga gruaja viktima e dhunës ose viktima e dhunës në familje, duhet të mbahet në konsideratë sa vijon:

- a) intervistimi të bëhet nga prokuror ose oficer i policisë gjyqësore femër;
- b) intervistimi të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur;
- c) viktimës t'i jepet mundësia të asistohet nga një person i besuar, koordinatori i viktimate ose psikologu, sipas rastit;
- d) nëse viktima ka fëmijë të mitur, të njoftohet njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe të shmanget prania e tij gjatë intervistimit të nënës/prindit;
- e) viktima gjatë intervistimit të ndihet e sigurt dhe t'i jepet mundësia të tregojë ngjarjen dhe ndikimin që pati tek ajo;
- f) viktima të pyetet nëse ka një histori dhune/abuzimi dhe/ose urdhër mbrojtjeje;
- g) gjatë intervistimit të komunikohet me gjuhë të kuptueshme për viktimen duke shhangur termat teknikë dhe pyetjet indirekte;
- h) viktima të përgatitet dhe të pyetet nëse është e gatshme të përgjigjet për pyetje intime dhe t'i shpjegohet pse kjo është e nevojshme;
- i) gjatë intervistimit viktima të mos orientohet drejt pajtimit me dhunuesin;
- j) gjatë intervistimit të dokumentohet gjendja fizike dhe emocionale e viktimës;
- k) kur viktima shfaq shenja të humbjes së kujtesës, mungesës së përqëndrimit, përgjigje shumë emocionale (tregues të traumës), të tregohet kujdes për të vendosur një komunikim që nuk shkakton rivictimizim dhe të ndihmohet të tejkalojë eksperiencën traumatike, duke vlerësuar kryerjen e një ekspertimi psikologjik.

Neni 6

Hetimi dhe ndjekja penale

1. Në shpërndarjen e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duhet të sigurohet sa është e mundur caktimi i atyre prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të specializuar dhe palëvizshmëria e tyre nga çështja.

2. Ndjekja penale duhet të jetë e shpejtë për të shhangur kërcënimet e presionin ndaj viktimës dhe vështirësitë që mund t'i shkaktohen asaj nga vonesa.⁸

3. Të vlerësohet këqyrja e menjëhershme e vendit të ngjarjes si mjet kërkimi prove, e cila mund të ndihmojë në procesin e të provuarit.

4. Gjatë gjithë procesit, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës. Përveç masave mbrojtëse të përshtatshme për viktimen⁹, vlerësimi i riskut të viktimës të shërbejë për të konsideruar dhe përgjedhur si masë sigurimi personal propacionale caktimin e masës “arrest në burg” për personin nën hetim dhe/ose të pandehurin.

5. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë viktimen për të drejtat e parashikuara në ligj dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr.5/2018, për të garantuar realizimin e

⁸ Shih, po aty edhe nenet 18, 48 dhe 50 (udhëzimi 5/2018).

⁹ Shih, po aty dhe nenin 31 (udhëzimi5/2018)

tyre¹⁰, si dhe personalisht ose nëpërmjet koordinatorit, t'i japid informacion viktimës lidhur me hapat që do të ndiqen për çështjen.

6. Hetimi duhet të jetë i plotë për të kërkuar, mbledhur, rishikuar dhe vlerësuar të gjithë provat e nevojshme si: foto, akte ekspertimi, histori mjekësore, telefonata në urgjencë, polici, etj., ndalime, arreste apo dënimë të mëparshme, armë, deklarime të personave të njohur, mësues, kolegë, fqinjë, familjarë, vlerësimi i riskut nga policia etj., urdhra mbrojtje, dosjen civile, etj.

7. Në fazën e dërgimit të kërkesës për gjykimin e çështjes, prokurori duhet të sigurohet për nivelin e riskut ku gjendet viktima, nëse është rasti për të vlerësuar dhe ngritur akuza të tjera ndaj të pandehurit, për të vlerësuar mundësinë e dëgjimit të viktimës nëpërmjet mjeteve audiovizuale, dhe/ose kërkuar e rekomanduar gjykatës masat e nevojshme mbrojtëse të saj.

8. Gjatë gjykimit prokurori duhet të jetë i përgatitur të kundërshtojë provat për karakterin e viktimës që nuk lidhen me ngjarjen, dhe për të menaxhuar sjelljen e viktimës si dëshmitar në gjyq, në mënyrë që të shmanget përpjekjet, në kundërshtim me rrethanat e vërteta të faktit të provuara, e palëve të interesuara në proces, që viktima të konsiderohet jobindëse apo e pavërtetë.

9. Prokurori duhet të administrojë prova të mjaftueshme dhe bindëse përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për fajësinë e të pandehurit dhe/ose përgatisë çështjen në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të gjykohet edhe pa dëshminë e viktimës.

KREU IV DHUNA ME BAZË URREJTJE

Neni 7 **Kuptimi i dhunës me bazë urejtje**

1. Veprat penale me bazë urejtje janë të gjitha ato akte të cilat plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- parashikohen nga ligji penal si vepra penale;
- kryhen për motive paragjykuese që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

2. Në veprat penale me bazë urejtje viktima sulmohet për shkak të përkatësisë ose dyshimit të përkatësisë së saj në një grup të caktuar. Në këto raste vepra penale mund të drejtohet ndaj një ose më shumë personave ose pasurisë.

Neni 8 **Garantimi i të drejtave viktimës së veprave penale më bazë urejtje**

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, garantojnë që viktima të njohë dhe ushtrojë të gjitha të drejtat e parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Veçanërisht, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, bëjnë përpjekje që viktimës t'i plotësohen nevojat e para jetike për siguri, ndihmë mjekësore, ushqim, veshmbathje e strehim

¹⁰ Shih, po aty, Kreu III , i udhëzimit 5/2018

dhe e informojnë viktimin për të drejtën për ndihmë juridike falas dhe për procesin e përfitimit të kësaj ndihme.

Neni 9
Identifikimi i motivit paragjykues

1. Në hetimin e veprave penale me bazë urrejtje, kur motivi paragjykues nuk është i dukshëm, si fakte e indicie për të vlerësuar mbi motivet paragjykuese të konsiderohet përdorimi i një ose disa nga treguesit e mëposhtëm:

- a) rrethana që lidhen me viktimin: i përket ose është i lidhur me një grupim minoriteti etnik, kombëtar, fetar, seksual, etj. Nëse objekt sulmi është prona, analizohet edhe funksioni i saj;
- b) rrethana që lidhen me autorin: i njohur nga policia apo komuniteti për përfshirjë në sulme apo sjellje të motivuara nga urrejtja;
- c) sjellja e autorit: komente, gjeste, deklarata, shenja, simbole, mbishkrime, qëndrimet e tij në mediat sociale;
- ç) rrethana që lidhen me kohën dhe vendin e ngjarjes: psh. në ditën e një festë fetare apo aktiviteti të një grupei, nëse disa krime kanë ndodhur në të njëjtin vend, ose vendi njihet si zonë e frekuentuar nga një grup minoriteti;
- d) perceptimi i viktimës ose dëshmitarit se akti ka qenë i motivuar nga paragjykimi;
- dh) brutaliteti i sulmit;
- e) nuk ka motive të tjera.

Neni 10
Hetimi i krimeve të urrejtjes

1. Hetimi i veprave penale me bazë urrejtje kërkon mbledhjen e provave të nevojshme për të provuar faktin penal, identifikuar autorin e veprës penale dhe provuar motivin paragjykues.

2. Për procesin e të provuarit, janë të rëndësishme prova që viktima i përket një grupei minoriteti, prova që i pandehuri e dinte që viktima i përkiste një grupei minoriteti dhe prova që i pandehuri ishte armiqësor ndaj viktimës për shkak se viktima i përkiste një grupei minoriteti.

3. Për të provuar motivin, prova të mundshme janë:

- a) shkrime në vendin e ngjarjes;
- b) deklarimet e viktimës;
- c) deklarimet e personave që kanë parë ngjarjen, mbi thënet e sulmuesit;
- ç) marrja e deklarimeve nga ana e personave që kanë patur kontakte me të dyshuarin para ngjarjes;
- d) deklarime të pranimit nga i dyshuar ose deklarime të personave që kanë patur kontakte me të dyshuarin pas ngjarjes.
- dh) foto, video ose të dhëna kompjuterike që tregojnë sulmin;
- e) incidente apo dënlime të mëparshme;
- f) postime në rrjete sociale;

KREU V
POLITIKA PENALE

Neni 11

Akuzat

1. Prokurori, në formulimin e akuzës, krahas kërkesave të tjera ligjore, duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e veprës, paramendimin dhe/ose vazhdimësinë e sjelljes së të pandehurit, dashjen, dëmin (fizik e psikologjik) të vuajtur nga viktima, vepra të tjera shoqëruese.

2. Prokurori duhet të vlerësojë sipas rastit, kryerjen e veprës në rrethana rënduese ose shtimin e akuzës lidhur me vepra të kryera para apo pas veprës që procedohet si: shkeljen e urdhrit të mbrojtjes, kundërshtim i punonjësit të policisë, kanosja për të mos kallëzuar, etj.

Neni 12

Kërkesa për dënimin e të pandehurit

1. Në kërkimin për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, prokurori merr në konsideratë rëndësinë dhe/ose rrezikshmérinë e veprës, vazhdueshmérinë dhe/ose përsëritjen e saj, rrezikshmérinë e autorit si person por edhe nevojat për rehabilitimin e tij, recidivizmin, pasojat e shkaktuara viktimës dhe/ose rrezikun për pasoja të mëtejshme ndaj saj, rrethanat rënduese, përhapjen e veprës penale në njësinë/rrethin gjyqësor apo në shkallë vendi dhe nevojën e shoqërisë për mbrojtjen dhe ndëshkimin e autorëve të këtyre veprave.

2. Rrethanat e parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “ç” “e” të nenit 48 të Kodit Penal, nuk shërbejnë për lehtësimin e dënimit në çështjet e dhunës me bazë gjinore ose ato të dhunës me bazë urrejtje.

3. Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar, të kërkohet rëndimi i dënimit bazuar në nenin 50 shkronja “j” e Kodit Penal.

Neni 13

Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative

Para se të kërkojë zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturit, prokurori duhet të vlerësojë së bashku me kushtet e tjera ligjore, kontekstin dhe kompleksitetin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe t'i kushtojë vemendje të veçantë sigurisë dhe nevojave të viktimës.

Neni 14

Gjykimi me marrëveshje

1. Në çështjet e dhunës ndaj grave, përveç kushteve e kritereve të përcaktuara në ligj, prokurori duhet të vlerësojë me kujdes dhe t'i shpjegojë viktimës avantazhet (p.sh. nevoja për të mos dëshmuar) dhe disavantazhet (dënim më i lehtë) për të.

2. Përveç parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, në çështjet e dhunës me bazë urrejtje, prokurori duhet ta bëjë pjesë të pranimit të fajësisë faktin se vepra është kryer e shtyrë nga motive diskriminuese.

3. Kur viktima ka të ngritur padi civile, prokurori e informon që masa e shpërbimit të dëmit do të jetë pjesë e marrëveshjes së fajësisë.

KREU VI

MASA TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 15

Kontrolli i veprimtarisë së policisë gjyqësore

1. Prokurori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë kontrollit të ligjshmërisë dhe profesionalizmit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore.

2. Prokurori duhet të vlerësojë çdo ankesë të paraqitur nga viktima, në lidhje me veprimtarinë e shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse.

3. Prokurori gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale duhet t'i kushtojë rëndësi marrjes së informacionit nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve, lidhur me pjesëmarrjen e të dënuarit për këto vepra në programe rehabilitimi dhe riintegrimi, si dhe ndikimin e këtyre programeve në edukimin e tij.

Neni 16

Bashkëpunimi

1. Drejtuesit e prokurorive duhet të nxitin bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me organizata të shoqërisë civile, në kryerjen e trajnimeve, hartimin e protokolleve e strategjive dhe trajtimin e rasteve ku përfshihen viktima të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje.

2. Drejtuesit e prokurorive duhet të garantojnë qëndrueshmërinë, pjesëmarrje të rregullt dhe aktive të prokurorëve dhe/ose punonjësve të tjera të ngarkuar, në takimet e ETN-së.

3. Përfaqësuesit e prokurorisë në ETN-në duhet të respektojnë angazhimet e marra përsipër dhe të informojnë drejtuesit e prokurorisë dhe prokurorët sipas specializimit, për çështjet e ngritura në takime.

4. Prokurorët në trajtimin e çështjes duhet të marrin masa gjithëpërfshirëse, jo vetëm në drejtim të garantimit të të drejtave ligjore të viktimateve, por duhet të sigurojnë që këto masa të koordinohen me ato të agjencive të tjera si Policinë e Shtetit, shërbimet sociale, në mënyrë që të jenë efektive dhe të kenë në qendër mbrojtjen e viktimës.

Neni 17

Mbledhja e të dhënave

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm, pas regjistrimit të procedimit dhe hapjes së dosjes penale, nga oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me çështjen do të plotësohet në vijimësi Kartela sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Koordinatori i viktimateve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm, do të mbajë dhe raportojë brenda datës 10 të muajve janar e korrik, në sektorin që mbulon asistencën ndaj viktimateve në Prokurorinë e Përgjithshme, të dhënat statistikore për viktimat, për periudha 6-mujore dhe vjetore, sipas modelit Ankes 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Të dhënat do të nxirren nga kartela e dosjes.

4. Procesi i mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore për viktimat vulnerabël, mbikëqyret nga drejtuesi i prokurorisë ose personi i autorizuar prej tij.

5. Ndihmësi i viktimateve në Prokurorinë e Përgjithshme, ndihmohet dhe bashkërendon me zyrën e Statistikës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në kuadër të veprimtarisë së sektorit dhe detyrimeve të prokurorisë.

Neni 18

Publikimi i informacioneve periodike

Prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm të publikojnë të paktën çdo vit, të dhëna për çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje, në mënyrë që ky informacion të shërbejë për të luftuar stereotipet dhe për të mbështetur viktimat në denoncimin e tyre.

Neni 19

Trajnimi

1. Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët e viktimateve, kanë të drejtë dhe detyrim të trajnohen mbi kuadrin legjislativ ndërkombëtar dhe kombëtar në këto fusha.

2. Trajnimet për prokurorët dhe policinë gjyqësore duhet të fokusohen edhe në teknikat e intervistimit, teknikat e strategjitet hetimore, arrestin dhe formulimin e akuzave, mbledhjen e provave, mbrojtjen e viktimateve, etj.

KREU VII

NJOHJA, PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 20

Njohja

Me këtë udhëzim të njihen gjithë prokurorët pranë prokurorive me juridikcion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve pranë strukturave hetimore përkatëse

në Policinë e Shtetit dhe të seksioneve të prokurorisë dhe koordinatorët e viktimave në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm.

Neni 21
Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose mosbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbënë vepër penale, mund të përbënë, shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm, sipas ligjit.

Neni 22
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët pranë prokurorive me juridikcion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve pranë strukturave hetimore përkatëse në Policinë e Shtetit dhe të seksioneve të prokurorisë, si dhe koordinatorët e viktimave në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridikzionit të përgjithshëm dhe Sektori i Monitorimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.¹¹

Neni 23
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

PROKURORI PËRGJITHSHËM



¹¹ Po aty nen 46 pikë 4.